



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3293/prot
12

Gramsh, më 02/09/2025

V E N D I M

Nr. 76 datë, 29/08/ 2025

PËR

PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË NR. 8, DATË 30.01.2025 "PËR NJË SHITESË NË LISTËN E INVENTARIT DHE KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH TË PRONËS ME ZK "TRUALL" ME NR 7/16 ME VENDODHJE NË QYTETIN GRAMSH BASHKIA GRAMSH E CILA DO PËRDORET SI "PIKË TRAJTIMI TË MBETJEVE TË GJELBËRTA DHE TË RICIKLUESHME PËR EKONOMINË QARKULLUESE."

Këshilli i Bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 29 /08/2025 , pasi mori në shqyrtim Relacionin dhe P/Vendimin nga Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Administrimit të Pronave Publike ,Nisur nga korespondenca me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe në zbatim të nenit 3, Kreu II të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore " të ndryshuar, të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit " të ndryshuar , , referuar VKM-së nr, 431 datë 11.07.2007 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh të qarkut Elbasan i ndryshuar, të vendimit nr. 500 datë 14.08.2001 të Këshillit të Ministrave "Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore "të ndryshuar ,udhëzimit nr.15 datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësia e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike " Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.2, shkronja "a", nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 20/2020 Kreu IV neni 39 pikat shkronja "b" "Për përfundimin e procedurave kalimtare të pronësisë në republikën e Shqipërisë" me Propozimin të Kryetarit të Bashkisë Këshilli i Bashkisë .

V E N D O S I:

- I. Miratimin e kërkesës për transferim të pronës me numër pasurie nr.7/16 , zona kadastrale 1842, me status juridik "Shtet" e cila ndodhet në qytetin e Gramshit ,sipas planit të rilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur si "Pikë e trajtimit të mbetjeve të gjelbërta dhe të riciklueshme për ekonominë qarkulluese"

- II.** Listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore ,që bashkëlidhet vendimit nr.431,datë 11.07.2007 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar ti shtohet prona me nr. Pasurie 7/16, zona kadastrale 1842 me status juridik “Shtet” që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh .

Bashkia Gramsh

Lidhja nr, 1

Numri rendor i pronave në Listën e inventarit	Fusha e Përdorimit të Pronës	Lloji i transferimit
521	Pikë e trajtimit të mbetjeve të gjelbërta dhe të riciklueshme për ekonominë qarkulluese	Në pronësi

Lista fillon me numrin rendor 521 (pesëqind e njëzetë e një) dhe përfundon me numrin rendor 521 (pesëqind e njëzetë e një) dhe ka gjithsej 1 (një) fletë.

III.Të gjitha pikat e tjera të P/Vendimit mbeten të pandryshuara.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit Mjedisit dhe Pronës dhe Sektori i Administrimit të Pronave Publike, Bashkia Gramsh .

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes !

KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI

